



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. _____ prot.
____ 2020

Tiranë, më ____ .

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: “AlbGarden” shpk, me adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godinë private 1 katëshe në supëstradën Lezhë – Shkodër, km 1, Lezhë.

Data: 15.06.2020

1. Procedura se prokurimit: “E Hapur”
2. Numri i referencës së procedurës: REF-52637-03-03-2020
3. Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është furnizimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me “Drure dhe Shkurre Dekorative”.
4. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në proçedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “AlbGarden” shpk	K 37513520 N
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Çmimi i ofertës është **26 000 000** (njëzet e gjashtë milion) **lekë pa Tvsh**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

2. “Green Farm” shpk	K 74727401 G
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Çmimi i ofertës është **21 000 000** (njëzet e një milion) **lekë pa Tvsh**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

Subjekte të s’kualifikuara:

1. **“Green Farm” shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

K 74727401 G
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk plotëson kapacitetin teknik, pika 3/c të DST-ve:

- Plotëson numrërin e punonjësve gërmat a, b të pikë 3, por nuk plotëson pikën ”c” ka paraqitur çertifikata për kopshtari por kopshtaria nuk mbulon punimet në fidanishte, punime të cilat janë të domosdoshme për objektin e prokurimit, drurë e shkurre dekorative.

Proceset teknike që kërkon fidanishtja nuk mund të plotësohen nga kopshtaria, e për pasojë mungesa e çertifikimit të punonjësve të OE sipas objektit të kontratës, përveç se nuk është në përputhje me kriterin e veçantë të kërkuar në pikën 3/c të Kapacitetit Teknik, por rrezikon ekzekutimin me sukses të kontratës, për arsye se duke iu referuar dhe afatit të lëvrimit që është nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 3.12.2020 do të thotë që operatori ekonomik fitues do të kryerjë gjitha shërbimet e nevojshme shërbimeve agrosilvikulturale profesionale, me qëllim mirëmbajtjen në kushte optimale të drurëve dhe shkurreve deri në momentin e furnizimit sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 10.

Sqarojmë se këto procese nuk mund të realizohen përveç se nga specialiste dhe teknike të trajnuar posaçërisht për këto procese, në të kundërt malli objekt kontrate do të prishej duke dështuar realizimin me sukses të kontratës e për rrjedhojë do të kemi të bëjmë me një dem ekonomik eventual.

Nuk plotëson kapacitetin teknik, pika 8 të DST-ve:

- Operatori Ekonomik (OE) ka paraqitur një kontratë me një distributor të huaj por kontrata nuk është shoqëruar me dokumentat:
- Çerifikate fitosanitare nga shteti importues
- Çertifikate origjine nga shteti importues
- Varietetet te jene te regjistruara ne katalogun kombetar shqiptar.
- Etiketat te jene te vendosura ne cdo bime

Pavarësisht se OE ka paraqitur një deklaratë, ku deklarohet se çertifikatat do të lëshohen nga furnizuesi në momentin e blerjes së bimeve, vlerësojmë se ky vetëdeklarim nuk mund të zëvendësojë dokumentet zyrtare të kërkuar nga AK për arsye se:

a) Certifikata Fitosanitare, bazuar në Ligjin nr. 105/2016 neni 2 pika 8, është dokumenti zyrtar i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve nga vendi i origjinës ose vendi prodhues, i cili tregon se kushtet fitosanitare të bimëve, produkteve bimore me rrezik dhe objekteve të tjera, plotësojnë standardet e sigurisë fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

b) Certifikata e Origjinës është “pasaporta” e bimës, pra është dokumenti identifikues i

bimës, I cili dhe shoqëron document .

Mungesa e dokumenteve të kërkuara në pikën 8 të DST-ve, për arsyet e sipërcituara e skualifikon automatisht ofertën e paraqitur.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **“AlbGarden” shpk**, me adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godinë private 1 katëshe në supëstradën Lezhë – Shkodër, km 1, Lezhë, me nr. Nipti K 37513520 N, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **26 000 000** (njëzet e gjashtë milion) lekë **pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Tiranë, me adresë: Rruga “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21/05/2020

Ankesa: Ka paraqitur ankesë operatori ekonomik **“Green Farm” shpk**, me nr. 612 prot, dt. 26/05/2020 ka marrë përgjigje me shkresën me nr. 612/3 prot, dt. 01/06/2020.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erinda FINO